



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.153, datë 06.12.2021

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT 4 TË VKB-SË NR.123, DATË 24.12.2020
“PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2021, SI DHE
PROJEKTBUXHETIN AFATMESËM TË BASHKISË DURRËS PËR VITET 2021-
2023”**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të Buxhetit”, VKB-së nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projektbuxhetin afat mesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 4 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”, si më poshtë vijon:

Pakësohet:

Programi buxhetor	Emërtimi projektit	Llog. Ekonomike	Fondi në lekë
01110	Rikonstruksioni i godinës së Bashkisë	231	5,000,000
	TOTALI		5,000,000

Shtohet :


Programi buxhetor	Emërtimi projektit	Llog. Ekonomike	Fondi në lekë
04520	Projekt zbatimi për ndërtimin e shëtitorës së plazhit Durrës nga Ura e Dajlanit deri në godinën e Kavalishencës	230	5,000,000
	TOTALI		5,000,000

- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimeve në Bashkinë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 06.12.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 958 pftot.



Durrës, më 13.12.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

13.12.21 12889/3

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.153 datë 06.12.2021 “Për miratimin e ndryshimit të aneksit 4 të VKB-së Nr 123 dt 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021, si dhe projekt buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

